



VENDIM
lidhur me Kërkesën për Masën e përkohshme

Rasti Nr. KI. 56/09

Fadil Hoxha dhe 59 të tjerët
vs.
Kuvendi Komunal i Prizrenit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në përbërjen për sa vijon:

Enver Hasani, kryetar
Snezhana Botusharova, gjyqtar
Robert Carolan, gjyqtar
Ivan Čukalović, gjyqtar
Iliriana Islami, gjyqtar
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar dhe
Altay Suroy, gjyqtar

me z-shën Albana Sopi si procesmbajtëse gjatë këshillimit dhe votimit të mbajtur më datën 25 nëntor 2009 lidhur me Kërkesën për vënien e masave të përkohshme në rastin KI Nr. 56/09 të paraqitur nga:

Kërkuesit

Zt. Fadil Hoxha dhe 59 të tjerët nga Komuna e Prizrenit.

Pala kundërshtare:

Palë Kundërshtare është Kuvendi Komunal i Prizrenit



Objekti i shqyrtimit

1. Kërkesa e parashtruesve e datës 17 tetor 2009 për caktimin e masës së përkohshme e paraqitur nga Fadil Hoxha dhe 59 të Tjerët si "kryefamiljarë të lagjes DARDANIA".

Baza juridike

2. Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 27 i Ligjit Nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të datës 16 dhjetor 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe neni 52 (1) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës)

Faktet

3. Me vendimin Nr. 01/011-3259 të datës 30 prill 2009, të nxjerrë nga Kuvendi Komunal i Prizrenit, është ndryshuar Vendimi i më hershëm i Planit të Detajuar Urbanistik i lagjes Jaglanica (tani Dardania), (në tekstin e mëtejme si: Vendimi i datës 30 prill 2009). Këto ndryshime, në pjesën e tyre përkatëse, janë specifikuar në nenin 2 të Vendimit të datës 30 prill 2009, dhe thuhet si vijon "Në pjesën grafike të planit teknik në tokat kadastrale..., në vend të zonave gjelbëruese të parapara Planin Detal Urbanistik, tani është paraparë ndërtimi i banese shumëkatëshe, i planifikuar për familjet e dëshmorëve dhe rastet sociale...".

4. Më 13 korrik 2009, parashtruesit kanë paraqitur një peticion në Kuvendin Komunal të Prizrenit duke kërkuar anulimin e Vendimit të datës 30 prill 2009. Në këtë Peticion parashtruesit, në veçanti, pohuan se vendimi kontestuar ishte miratuar në kundërshtim me nenet përkatëse të Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor (No 2003/14) dhe Ligjit për vetëqeverisje lokale (No.03/L-040).

5. Më 11 shtator 2009 parashtruesit kanë paraqitur një Kërkesë-Referim në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar Gjykatës për të vlerësuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e vendimit të 30 prill 2009.

6. Më 17 tetor 2009, parashtruesit e kanë plotësuar Kërkesë-Referimin me argumente shtesë dhe i kërkuan Gjykatës të vendos Masat e Përkohshme duke urdhëruar palën kundërshtare që menjëherë të ndërpres çdo veprim ose punë në atë ngastër duke pasur parasysh shmangien e ndonjë dëmi të pariparueshëm.

Pohimet e parashtruesve

7. Parashtruesit pohuan se janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 52(2) të Kushtetutës, që thotë: "Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton. "

8. Parashtruesit më tutje pohuan se ekziston një rrezik i drejtpërdrejtë që punimi në ngastrën në fjalë do t'u shkaktojë atyre dëme të pariparueshme, prandaj kërkuan nga Gjykata që të vendos Masën e Përkohshme me efekt të menjëhershëm.



Komentet e palës kundërshtare

9. Kuvendi Komunal i Prizrenit, në parashtresat me shkrim të datës 11 nëntor 2009, kundërshtoi pohimet e parashtruese të paraqitura në Kërkesë-Referimi. Në veçanti, pala kundërshtare vërtetoi se i Vendimi i datës 30 prill 2009 u miratua në pajtueshmëri Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe se ngastra në fjalë është klasifikuar si pronë publike, e cila jep të drejtën Kuvendit Komunal të Prizrenit për një zhvillimin të balancuar dhe gradual të asaj parcele dhe planifikimit hapësinor.

GJYKATA KUSHTETUESE

10. Pasi ka dëgjuar gjyqtarin raportues, Zt. Altay Suroy, si dhe pasi ka diskutuar pikëpamjet e palëve të shprehura në parashtresat e tyre me shkrim, më datën 25 nëntor 2009 ka hyrë në këshillim. Gjykata vendosi, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar të Kërkesë-Referimit, që parashtruesit kanë ofruar argumente bindëse të mjaftueshme për të provuar se kërkesa për masë të përkohshme është e arsyeshme dhe e justifikuar, pasi që zbatimi i vendimit të kontestuar i datës 30 prill 2009 mund të rezultojë me dëmtime të riparueshme për kërkuesit.

11. Rrjedhimisht, kërkesën e parashtruesve për masë të përkohshme Gjykata e shpalli si të arsyeshme dhe të justifikuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në pajtim me nenin 116 (2) të Kushtetutës, nenin 27(1) të Ligjit, si dhe nenin 52(1) të Rregullores së punës, me shumicë votash,

VENDOSI

I. LEJOHET vënia e masave të përkohshme për një kohë jo më të gjatë se tre (3) muaj nga dita e dhënies së këtij Vendimi

II. PEZULLOHET menjëherë ekzekutimi i "Vendimit mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit të Planit Urban të Detajuar (PUD) të Lagjes JAGLENICA në Prizren", i miratuar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit më 30 prill 2009 me Nr. 01/011-3257, me kohëzgjatje të njëjtë si nga paragrafi i këtij Vendimi

III. Kuvendi Komunal i Prizrenit URDHËROHET që të pezullojë çdo ndërtim në lagjen e sipërcekur për një kohë të njëjtë si në paragrafët I dhe II të këtij Vendimi

IV. Ky Vendim u dërgohet Palëve

V. Ky Vendim publikohet në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Dr. Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

